



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 24. 03. 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Nerxhivane Dauti, Drita Maliqi, Shpresa Murati dhe Vezira Emrush – anëtarë.

Të ftuar: ministri i Arsimit, z. Enver Hoxhaj, ministri i Shëndetësisë z. Alush Gashi, rektori i Universitetit të Prishtinës, z. Enver Hasani, dekani i Fakultetit të Mjekësisë, z. Qazim Hysenaj, si dhe përfaqësuesit e petitionit: dr. Shqiptar Demaçi, dr. Arben Morina, dr. Argeta Gecaj – Gashi, dr. Aurora Bakalli, dr. Luan Jaha, Hasime Bacaj, Imri Vishi, Kujtim Shala dhe Florije Asllanaj.

Mbledhjen e mbikëqyrën: Besnik Gashi – *Klan Kosova*, Ardita Uka - *Zëri*, Leonora Makolli - *RTV-21*, Nexhat Shatri, Xhemajl Ahmeti - OHCHR, Ilita Vokshi - OSBE, Shqipe Hetemi - *Epoka e re*, Rrezarta Ahmeti - KDI dhe Blerina Uka - NDI.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinators, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi zyrtar ligjor.

R e n d i i d i t ë s

1. Takimi me ministrin e Arsimit, z. Enver Hoxhaj, me ministrin e Shëndetësisë, z. Alush Gashi, me rektorin e Universitetit të Prishtinës, z. Enver Hasani, me dekanin e Fakultetit të Mjekësisë, z. Qazim Hysenaj dhe me përfaqësuesit e petitionit.

Tema : Shqyrtimi i petitionit të nënshkruar nga 125 magjistra të shkencave mjekësore, me të cilin kërkohet t'u lejohen studimet e doktoratës.

Kryesuesi konstatoi se *ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1 Shqyrtimi i petitionit të nënshkruar nga 125 magjistra të shkencave mjekësore, me të cilin kërkohet t'u lejohen studimet e doktoratës

Ismet Beqiri – Njoftoi për përmbajtjen e petitionit, në të cilin kërkohet t'u mundësohet vazhdimi i studimeve të doktoratës sipas normave në fuqi në kohën e regjistrimit të studimeve pasuniversitare. Ceku se ndërprerja arbitrare nga ana e Senatit të Universitetit të Prishtinës do të ishte hendikep i madh për nënshkruarit e petitionit, prandaj e ftoi përfaqësuesin e petitionit ta merrte fjalën.

Enver Hasani – I vlerësoi si të papranueshme kërkesat e doktorantëve që të vazhdohet me sistemin e vjetër. Sipas tij kjo është në kundërshtim me trendin evropian, sepse regjistrimi i 480 kandidatëve, është trefishi i studentëve në *bachelor*, në Fakultetin e Mjekësisë. E konsideroi të kundërligjshme dhe ishte i bindur se do të ketë kundërshtime nga asociacionet e universiteteve evropiane për regres - kthim prapa dhe degradim të studimeve të Fakultetit të Mjekësisë. Ia tërhoqi vërejtjen Komisionit se e drejta e doktoratës, nuk është e drejtë kolektive, as lineare. Sipas kësaj konsideron se kërkesa e më se 200 mjekëve nuk është e drejtë. Çfarëdo vendimi që do të merrej do të ishte shkelje e Statutit të UP-së, të miratuar në Kuvendin e Kosovës. E kam për detyrë ta paraqes problemin ashtu siç e shoh. Jam i sigurt se kjo mënyrë e interpretimit të Ligjit dhe të Statutit është sipas standardeve dhe trendeve evropiane. Çdo rrugë tjetër çon në vetëshkatërrim dhe në degjenerim të Universitetit.

Alush Gashi – ministër – Pasi i përshëndeti të pranishmit u angazhua për zgjidhjen e çështjes së shtruar në peticion. Theksoi se rasti kërkon zgjidhje *sui generis*.

Enver Hoxhaj – ministër – Tha se çështja e doktoratës duhet të zgjidhet brenda UP-së. Universiteti është autonom. Preferojmë që problemet e UP-së të zgjidhen brenda tij. E mbështeti diskutimin e kolegut, z. Alush Gashit, për zgjidhje *sui generis*. Është i bindur se do të ofrohen modalitete për zgjidhje në kuadër të kornizave të Komisionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Qazim Hyseni – Dekan i Fakultetit të Mjekësisë – Pasi e falënderoi Komisionin për ftesën, shtoi se do të ishte mirë të formohet një komision i përbashkët i Rektoratit dhe i Dekanatit që të gjendet zgjidhje e problemit të krijuar lidhur me doktoratat. Ishte këmbëngulës të realizohej kërkesa e tyre.

Shqiptar Demaçi – Komisionin dhe të pranishmit i njoftoi për kronologjinë e problematikës, me të cilën ballafaqohen nënshkruesit e peticionit. Problemi i tyre ka nisur nga 6 tetori i vitit 2005, kur Senati i UP-së, me një vendim të brendshëm, i suprimoi vendimet e mëparshme për t'i dhënë temat e doktoratës deri më 31 gusht 2005. Ceku se kanë magjistruar 250 kandidatë të shkencave të mjekësisë dhe vetëm 135 prej tyre janë ftuar në konkursin e shpallur për vazhdimin e studimeve të doktoratës. Veprimin e Senatit e cilësoi shkelje të të drejtave të njeriut.

Luan Jaha - Tha se 136 kandidatët nuk pranojnë t'i regjistrojnë studimet e doktoratës, sepse thonë se i kanë kryer. Sipas normave statusore, që vlejné kudo në rajon, thonë se nuk kanë nevojë për as një ditë shkollë me tepër se ç'kanë kryer. Është manipulim kur rektori thotë se po dëshirojmë të regjistrohemi në studime. Kjo krijon frikë dhe panik se ku do të hyjnë këta 400 veta dhe ku do të gjendeshin paratë për ta etj.

Kujtim Shala - shef i Katedrës së Stomatologjisë – Tha se Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për arsimin e lartë, ku bën pjesë edhe Statuti i UP-së. Sipas tij u mohohet 134 specialistëve e drejta e doktoratës, sepse ata profesionalisht janë të përgatitur dhe janë ajka e inteligjencies kosovare. Ne duam ta sprovojmë veten në shkencë. Kërkesë e tyre ishte të caktoheshin temat e doktoratës për 134 magjistra, t'u mundësohej t'i kryenin ato, të gjendej zgjidhje për kandidatët e zgjedhur legalisht të doktoratës së viti 2005 – 2006 dhe të shpallet i pavlefshëm konkursi i fundit diskriminues i doktoratës, i janarit 2009.

Ibrahim Makolli – E pyeti rektorin a janë shkelur Statuti i UP-së dhe ligjet e tjera, sidomos konkursi i 6 tetorit të vitit 2005? Kërkoj të hiqet kriteri i moshës. Ishte i mendimit të merrej nisma për amedamentimin e Ligjit të arsimit të lartë.

Nerxhivane Dauti – Vuri në pah se do të shqyrtohet me kujdes ligjshmëria e procedurës së konkursit për doktoratë. Në bazë të vlerësimit të kriterëve të nxirren rekomandime dhe të sigurohet se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi.

Drita Maliqi - Shprehu keqardhje se nënshkruetit e peticionit nuk po i realizojnë të drejtat e tyre. Pyeti se a ishte në plan të ndryshohej dhe të plotësohej Rregullorja, sepse në vitin 2005 kjo kategori e studentëve ishte e regjistruar? A ndihet fajtor rektori për këta kandidatë, që nuk u është mundësuar t'i vazhdojnë studimet e doktoratës në ato vite?

Apeloi të gjendet bazë ligjore për tejkalimin e gjendjes së krijuar në Universitetin e Prishtinës.

Vezira Emrush – U angazhua për zgjidhjen e kësaj çështjeje, nga se ka elemente të mospërfilljes së kriterëve të konkursit. U pajtua me parafolësit që kjo çështje të trajtohet si *suigeneris*.

Sanije Alijaj – E mbështeti diskutimin e ministrit Alush Gashi, ndërsa për peticion tha se jemi të njoftuar. Kriteret e konkursit të shpallur nuk janë respektuar. Doktorata është e drejtë individuale dhe secili nga nënshkruetit e peticionit e di këtë, por shkëlja e kësaj së drejte i ka shtyrë të përpiqen ta realizojnë atë. U angazhua të gjendej një zgjidhje. Konsideron se ata nuk janë fajtorë, por për fat të keq të tyre, Kosova u gjend në fazën e transicionit në kohën kur ata studionin. Nga ministri i arsimit kërkoi, nëse është pengesë Ligji i arsimit, të amendamentohet dhe të zbatohet tërësisht. Nga rektori dhe nga institucionet arsimore kërkohet të angazhohen që për këta kandidatë, që na janë drejtuar me peticion, të gjendet zgjidhje brenda Universitetit.

Ibrahim Makolli – Sërish pyeti kush e cakton numrin e doktorantëve dhe a janë të trajtuar të gjithë njësoj?

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigjën rektori, Enver Hasani dhe ministri, Enver Hoxhaj.

Ismet Beqiri – kryetar – Në përmbyllje të debatit, theksoi se rekomandimet për këtë problematikë do të bëhen javën e ardhshme në bazë të vlerësimit të ligjshmërisë së konkursit për doktorata të vitit 2005 dhe 2009.

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv për këtë pikë, Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni mori vendim që më 3. 04. 2009 të dalë me rekomandime për këtë peticion.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 00.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri